FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 76	2003	Shtator

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.584, datë 28.8.2003	Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave…….	3459
Vendim i GJL nr.4, datë 27.3.2003	Me objekt konvertimin e dënimit, në bazë të nenit 283/1 të Kodit Penal ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001……	3466
Vendim i GJL nr.31, datë 14.4.2003	Me objekt anulimin e urdhrit nr.298 datë 22.4.2002 të Drejtorit të Policisë së Qarkut Shkodër……	3470
Vendim i RE-s nr.15, datë 27.8.2003	Për dhënien e licencës për shfrytëzim të centraleve elektrike dhe prodhim të energjisë elektrike shoqërive "ESSEGEI-SMOKTHINA" sh.p.k. "Sarollari" sh.p.k. "Sarmier" sh.p.k…	3479
Urdhër i MB nr.17/3, datë 18.8.2003	Për miratimin e Statutit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP Durrës)……	3479

V E N D I M
Nr.584, datë 28.8.2003

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21 pika 4, 22 pikat 2, 23 pika 2, 24 pikat 4 dhe 25 pika 4 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr.81, datë 6.2.1995 i Këshillit të Ministrave "Për rregullat e funksionimit të Këshillit të Ministrave", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

RREGULLORE
E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Kjo rregullore ka si qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave lidhur me:

a) përgatitjen dhe paraqitjen e projektakteve, si dhe shqyrtimin e tyre në Këshillin e Ministrave;

b) organizimin e mbledhjeve të Këshillit të Ministrave.

2. Në zbatim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) "Ministri propozues" është ministri që ka filluar procedurat për hartimin e projektaktit dhe pasi ka marrë vlerësimet paraprake, e propozon projektaktin për shqyrtim e miratim në Këshillin e Ministrave.

b) "Nismë propozuese" është ushtrimi i së drejtës ligjore për të hartuar dhe propozuar për shqyrtim e miratim projektakte.

c) "Projektakti" është projekti i një ligji, akti me fuqinë e ligjit, sipas nenit 101 të Kushtetutës, vendimi ose udhëzimi që paraqitet për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave.

ç) "Programi analitik i projektakteve" është lista e projektakteve që parashikohen të hartohen dhe të paraqiten për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, sipas programit të ministrive.

KREU II
NISMA PËR PROJEKTAKTIN

3. Kryeministri dhe çdo ministër kanë të drejtën e propozimit të projektakteve për shqyrtim në Këshillin e Ministrave.

4. Ministrat e ushtrojnë këtë të drejtë në përputhje me fushat e veprimtarisë shtetërore që kanë në kompetencë, si dhe me përgjegjësitë që burojnë nga strategjitë dhe dokumentet e tjera të miratuara për drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore. Kryeministri e ushtron këtë të drejtë në çdo rast, kryesisht ose kur kjo e drejtë nuk është ushtruar nga ministri përkatës.

5. Projektaktet që përmbajnë normimin e drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore propozohen për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave nga Kryeministri. Sipas

vlerësimit të tij, bashkëpropozues të projektaktit mund të jenë edhe një ose disa ministra të tjerë.

6. Kur fusha e marrëdhënieve që rregullon projektakti lidhet me veprimtari, të cilat janë në kompetencë të më shumë se një ministri, nisma për propozimin e tij për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, ushtrohet bashkërisht nga ministrat përkatës.

7. Si rregull, brenda muajit dhjetor të çdo viti kalendarik dhe në çdo rast, brenda afatit të caktuar nga Kryeministri, sipas fushës së veprimtarisë që kanë në kompetencë, ministrat i paraqesin Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave projektprogramin e hollësishëm të projektakteve që parashikojnë të propozojnë për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave në vitin pasardhës.

8. Projektprogrami i detajuar i projektakteve për çdo fushë veprimtarie duhet të jetë i ndarë në katërmujorë dhe të përmbajë:

a) listën e projektakteve që parashikohen të propozohen për shqyrtim në Këshillin e Ministrave,

b) afatin e paraqitjes se tyre pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, me qëllim shqyrtimin në mbledhjen e Këshillit të Ministrave;

c) relacion të hollësishëm me shpjegimet e nevojshme lidhur me arsyet kryesore për propozimin e projektaktit, çështjet më të rëndësishme që parashikohen të rregullohen prej tij, përputhshmërinë me programin politik të Këshillit të Ministrave, me programet kombëtare ose sektorale të zhvillimit të vendit.

9. Kryeministri bashkërendon procesin e përgatitjes së programit analitik të projektakteve dhe e propozon për miratim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave.

10. Pas miratimit të programit analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave, sipas fushës së veprimtarisë që ka në kompetencë, ministri urdhëron miratimin e programit të hollësishëm të masave, afateve dhe strukturave përgjegjëse për zhvillimin e procesit legjislativ në tërësi dhe për çdo projektakt, raportimin për ecurinë e tyre deri në përfundimin e hartimit të projektaktit dhe paraqitjen e tij për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave.

11. Ministri propozues ua dërgon projektaktin për mendim ministrive dhe institucioneve të interesuara, jo më vonë se 30 ditë përpara datës së përcaktuar në programin analitik të miratuar.

KREU III
PËRGATITJA E PROJEKTAKTIT

12. Përpara fillimit të procesit të hartimit të projektaktit, strukturat teknike në bashkërendim me strukturën juridike, bëjnë vlerësimin paraprak të nismës për propozimin e projektaktit ku përfshihen, ndërmjet të tjerave, shpjegime lidhur me:

a) qëllimin e projektaktit dhe objektivat që synohen të arrihen;

b) përputhshmërinë me programin politik dhe me programin analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave, si dhe me strategjitë e programet e miratuara mbi drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore;

c) pajtueshmërinë me Kushtetutën dhe me legjislacionin në fuqi;

ç) parashikimet dhe masat, që kanë të bëjnë me zbatueshmërinë e projektaktit;

d) shpenzimet buxhetore dhe efektet financiare të pritshme.

13. Mbështetur në vlerësimin paraprak të projektaktit, ministri cakton me urdhër të veçantë çështjet që duhen rregulluar, format e pjesëmarrjes dhe hapat kryesore të realizmit dhe bashkërendimit të procesit legjislativ, afatet përkatëse për realizimin e tyre, strukturat përgjegjëse, si dhe burimet njerëzore dhe materiale që ngarkohen të bashkëpunojnë me strukturën juridike për hartimin e çdo projektakti.

14. Projektaktet hartohen nën përgjegjësinë e strukturës juridike, e cila në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse dhe ato të fushave përkatëse të ministrisë, organizon këshillime me drejtues a specialistë të drejtorive, sektorëve a enteve, si dhe me struktura të shoqërisë civile, veprimtaria e të cilave lidhet me objektin, qëllimin dhe zbatimin e projektaktit.

15. Për përgatitjen e projektakteve, struktura juridike mund të kërkojë mendimin e ekspertëve

të tjerë, brenda ose jashtë ministrisë.

16. Në bashkërendim me strukturën juridike, strukturat përgjegjëse përpilojnë relacionin shpjegues të projektaktit, raportin e vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, si dhe mbi burimet financiare, si dhe plotësojnë dokumentacionin e nevojshëm shoqërues përpara se t'i dërgohen për shqyrtim ministrit.

17. Në përfundim të konsultimeve dhe shqyrtimit të projektaktit, relacionit shpjegues, raportit të vlerësimit ekonomik dhe dokumentacionit shoqërues, ministri pasi vlerëson nismën, vendos dërgimin e tyre për mendim në ministritë dhe institucionet e interesuara ose urdhëron rishikimin e tyre brenda një afati të caktuar prej tij.

18. Projektakti i dërguar për mendim duhet të shoqërohet me relacionin shpjegues dhe me raportin e vlerësimit të shpenzimeve buxhetore për zbatimin e tij.

19. Relacioni shpjegues duhet të përmbajë:

a) Qëllimin e projektaktit dhe objektivat që synohen të arrihen.

b) Vlerësimin politik dhe lidhjen ose jo të projektaktit me programin politik të Këshillit të Ministrave, aktet që kanë miratuar drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, si dhe dokumente të tjera për strategjitë dhe politikat e zhvillimit.

c) Argumentimin e propozimit të projektaktit, duke bërë analizën lidhur me përparësitë dhe problemet e mundshme në zbatimin e projektaktit, nivelin e efektivitetit, zbatueshmërisë, efiçencës, impaktit dhe efekteve përkatëse, si dhe kostos ekonomike që rezulton në raport me legjislacionin në fuqi.

ç) Vlerësimin paraprak të ligjshmërisë dhe përputhshmërisë së formës dhe përmbajtjes së projektaktit me Kushtetutën, harmonizimin e tij me legjislacionin në fuqi dhe me normat e së drejtës ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë.

d) Vlerësimin eventual për projektaktet normative, të shkallës së përafrimit të përmbajtjes së tyre me legjislacionin komunitar (acquis communautaire).

dh) Përmbledhje shpjeguese të përmbajtjes së projektaktit.

e) Institucionet dhe organet që ngarkohen për zbatimin e aktit.

ë) Personat dhe institucionet që kanë kontribuar në hartimin e projektit.

20. Raporti i vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore duhet të përmbajë:

a) shumën e përgjithshme të shpenzimeve vjetore për zbatimin e aktit;

b) parashikimet e hollësishme për çdo zë të buxhetit, të nevojshme për zbatimin e aktit;

c) kohën e fillimit të efekteve financiare;

ç) shpenzimet e detajuara për strukturat që ngarkohen me zbatimin e aktit;

d) burimet e sigurta dhe të pritshme të financimit;

dh) analizën e rritjes apo të pakësimit të shpenzimeve buxhetore, të paktën për tre vitet e para të zbatimit të tij;

e) vlerën e detyrimeve fiskale të pritshme apo të përjashtuara, që parashikon projektakti;

ë) kur projektakti ka për objekt miratimin e përdorimit apo të shpërndarjes së fondeve publike, shoqërohet me preventivin përkatës.

21. Për projektaktet që kanë objekt miratimin ose ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, plotësimi i të dhënave sipas pikave 19 dhe 20 të kësaj rregulloreje, të përgatiten përpara miratimit të tyre në parim.

KREU IV
DHËNIA E MENDIMEVE PËR PROJEKTAKTIN

22. Të gjitha projektaktet pa përjashtim i dërgohen për mendim Ministrit të Drejtësisë, i cili duhet të shprehet lidhur me ligjshmërinë e formës dhe të përmbajtjes, për çështjet e zbatimit të unifikuar të teknikës legjislative dhe për terminologjinë juridike të projektaktit duke parashtruar, kur është rasti, edhe formulimet përkatëse.

23. Nëse projektakti shoqërohet me efekte financiare në të ardhurat dhe shpenzimet e Buxhetit të Shtetit, në çdo rast i dërgohet për mendim Ministrit të Financave dhe sipas rastit, Ministrit të Ekonomisë.

24. Nëse projektakti përmban çështje që lidhen me disponimin dhe administrimin e pronave publike dhe shtetërore, me financime të huaja dhe marrëdhënie ekonomike me jashtë, si dhe me impakte në ecurinë e zhvillimit të ekonomisë, në çdo rast i dërgohen për mendim Ministrit të Ekonomisë dhe sipas rastit, Ministrit të Financave.

25. Projektaktet me karakter normativ i dërgohen për mendim Ministrit të Shtetit për Integrimin, që jep vlerësimin e tij lidhur me nevojën ose shkallën e përafrimit të tij me legjislacionin komunitar (acquis communautaire), përshtatshmërinë me legjislacionin ndërkombëtar, si dhe pajtueshmërinë me angazhimet kundrejt strukturave ndërkombëtare.

26. Të gjitha projektaktet me objekt miratimin në parim të marrëveshjeve ndërkombëtare i dërgohen për mendim Ministrit të Punëve të Jashtme.

27. Projektaktet me përmbajtje shoqërore, me efekte në burime njerëzore, i dërgohen për mendim Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe Departamentit të Administratës Publike.

KREU V
BASHKËRENDIMI I PROJEKTAKTEVE

28. Ministrat dhe titullarët e institucioneve të interesuara ia dërgojnë mendimin e tyre për projektaktin, ministrit propozues në formë shkresore, jo më vonë se 7 ditë-pune nga data e marrjes se tij. Për Ministrin e Drejtësisë, në rastin e projektligjeve, marrëveshjeve ndërkombëtare dhe akteve nënligjore voluminoze ky afat është 10 ditë-pune.

29. Mendimet e ministrave dhe institucioneve të interesuara përmbajnë vërejtje, komente ose sugjerime për çështje teknike të formës dhe përmbajtjes së projektaktit, relacionit shpjegues, raportit të vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe dokumentacionit tjetër shoqërues duke u përqëndruar, si rregull, në dhënien e mendimit të specializuar sipas fushave përkatëse të veprimtarisë që kanë në kompetencë.

30. Projektakti ripunohet duke marrë parasysh vërejtjet dhe sugjerimet e ministrave dhe të titullarëve të institucioneve të tjera të interesuara. Vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga Ministri i Drejtësisë dhe sipas rastit ministrat e treguar në pikat 23 deri 27 të kësaj rregulloreje, shihen me përparësi gjatë ripunimit të projektaktit.

31. Mendimi juridik i Ministrit të Drejtësisë, lidhur me ligjshmërinë e formës dhe të përmbajtjes së projektaktit, reflektohet në ripunimin e projektaktit nga ministri propozues, duke zhvilluar për këtë qëllim, nëse çmohet e nevojshme, konsultime të përbashkëta ose ridërguar atë për mendim përfundimtar.

32. Në rastin e dhënies së mendimeve që synojnë të propozojnë zgjidhje të tjera alternative ose që kundërshtojnë pjesërisht a tërësisht thelbin e përmbajtjes së projektaktit, ministri duhet të paraqesë për çdo çështje edhe argumentet përkatëse dhe kur është rasti, riformulimet e nevojshme të dispozitave të projektaktit.

33. Kur nga përmbajtja e mendimeve të dërguara nga ministrat dhe titullarët e institucioneve të interesuara, rezulton se ato sugjerojnë zgjidhje të tjera alternative ose që kundërshtojnë pjesërisht a tërësisht thelbin e përmbajtjes së projektaktit, ministri propozues mund të vendosë:

a) tërheqjen e plotë ose të pjesshme të propozimit të projektaktit;

b) rishikimin e përmbajtjes së tij edhe me anë të konsultimeve me ministrat përkatës;

c) kur çmon se nga procesi i konsultimeve sipas shkronjës "b" të kësaj pike nuk zgjidhen kundërshtitë dhe mosmarrëveshjet ose zgjidhjet alternative të sugjeruara ose kundërshtimet janë të paargumentuara, i dërgon menjëherë Kryeministrit, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, kërkesën e motivuar për bashkërendimin e qëndrimeve dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet tij dhe ministrave përkatës, së bashku me projektaktin dhe dokumentacionin sipas pikës 45 të kreut VI të kësaj rregulloreje.

34. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave kur vëren se projektakti dhe dokumentacioni që e shoqëron nuk përmbush kriteret e pikës 47, shkronjat "a" dhe "b" të kreut VI të

kësaj rregulloreje, vendos kthimin e motivuar të projektaktit ministrit propozues.

35. Kur projektakti dhe dokumentacioni që e shoqëron është i plotë, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave vendos dërgimin e tij për shqyrtim nga Kryeministri, duke i bashkëlidhur një relacion shpjegues teknik për përmbajtjen, problematikën dhe zgjidhje të mundshme të sugjeruara lidhur me kundërshtitë dhe mosmarrëveshjet e evidentuara.

36. Kryeministri vendos sipas rrethanave:

a) thirrjen në konsultë të ministrave të interesuar dhe personave të tjerë që çmohen prej tij, përpara se të marrë vendimin përkatës;

b) delegimin e zgjidhjes së çështjeve Zëvendëskryeministrit ose Ministrit të Shtetit të ngarkuar me koordinimin qeveritar ose Sekretarit të Përgjithshëm, kur thelbi i kundërshtive lidhet vetëm me çështje të ligjshmërisë. Së bashku me delegimin, Kryeministri cakton edhe modalitete dhe afatet përkatëse të kësaj procedure dhe për raportin e rezultateve që duhet t'i paraqiten për miratim ose vendimmarrje;

c) dërgimin e projektaktit për shqyrtim dhe konsultim më të gjerë në komitetet ndërministrore.

37. Në rastin e shkronjes "a" të pikës 36 të kësaj rregulloreje, ministri propozues dhe ministrat e titullarët e tjerë të institucioneve të interesuara marrin masa për zbatimin e vendimit të Kryeministrit në mënyrën dhe afatin e caktuar prej tij.

38. Në rastin e shkronjës "b" të pikës 36 të kësaj rregulloreje, autoriteti i deleguar organizon konsultimin me pjesëmarrjen e ministrave të interesuar dhe funksionarëve të tjerë politikë dhe sipas rastit, të departamentit juridik dhe atij të koordinimit në aparatin e Këshillit të Ministrave, të strukturave juridike dhe teknike të ministrive të interesuara dhe personave të tjerë që mund të japin kontribut në zgjidhjen e çështjes. Në përfundim të konsultimit, autoriteti i deleguar i raporton me shkrim Kryeministrit duke propozuar për miratim ose vendimmarrje zgjidhjet eventuale të çështjes.

39. Në rastin e shkronjës "c" të pikës 36 të kësaj rregulloreje, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave merr masat për përfshirjen e çështjes në rendin e ditës dhe organizimin e mbledhjes së Komitetit Ndërministror, sipas modaliteteve dhe afateve të caktuara nga Kryeministri.

40. Nëse është e nevojshme, sipas urdhërimeve të Kryeministrit, Sekretari i Përgjithshëm kujdeset për reflektimin teknik të zgjidhjeve të arritura, me pjesëmarrjen, sipas çmimit të tij të departamentit juridik dhe atij të koordinimit në aparatin e Këshillit të Ministrave, të strukturave juridike dhe teknike të ministrive dhe institucioneve të interesuara ose ekspertëve të tjerë.

41. Në përjashtim nga rregulli i përgjithshëm dhe për arsye të motivuara, për çështje dhe projektakte të një rëndësie të veçantë, Kryeministri nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, mund të vendosë përfshirjen e tyre në rendin e ditës së mbledhjes së Komitetit Ndërministror dhe shpërndarjen e materialeve të tij, pa kërkuar përmbushjen ose plotësimin e një apo më shumë elementeve të procedurave të bashkërendimit paraprak. Në këtë rast, ministri propozues, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, duhet t'u shpërndajë anëtarëve të komitetit kopje të projektit, të relacionit dhe të materialeve shoqëruese, në çastin që njoftohet data dhe rendi i ditës për mbledhjen e komitetit ndërministror.

42. Nëse projektakti miratohet në komitetin ndërministror, paraqitet për miratim në mbledhjen më të afërt të Këshillit të Ministrave. Kur për projektin nga Komiteti Ndërministror janë bërë vërejtje, ministri propozues i reflekton ato dhe paraqet projektin e ripunuar, së bashku me materialet shoqëruese, për miratim në Këshillin e Ministrave.

KREU VI
PARAQITJA E PROJEKTAKTEVE PËR SHQYRTIM NË KËSHILLIN E MINISTRAVE

43. Në përfundim të procesit të hartimit dhe të bashkërendimit me mendimet e ministrave dhe të drejtuesve të institucioneve të interesuara, ministri propozues paraqet projektaktin për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave.

44. Projektakti, relacioni shpjegues, dokumentet e përcaktuara në pikën 45 të kësaj

rregulloreje, në dy kopje origjinale, së bashku me shkresën përcjellëse i dërgohen Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, të paktën 10 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e Këshillit të Ministrave.

45. Propozimet e projekteve shoqërohen me:

a) projektaktin e bashkërenduar me ministritë përkatëse;

b) relacionin shpjegues, i cili përveç të dhënave të parashikuara në pikat 19 dhe 20 të kreut të katërt të kësaj rregulloreje, duhet të përmbajë edhe shpjegime për arsyet e mosreflektimit të vërejtjeve ose sugjerimeve të bëra nga ministritë e interesuara;

c) mendimet e ministrave dhe të drejtuesve të institucioneve të interesuara. Në çdo rast mendimi i Ministrit të Drejtësisë duhet të shoqërojë projektaktin;

ç) tekstin e plotë të traktatit a marrëveshjeve ndërkombëtare, në gjuhë të huaj dhe në shqip, të vërtetuar zyrtarisht nga Ministria e Drejtësisë, kur projektakti ka këtë objekt.

46. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, kur vëren se dokumentacioni që shoqëron projektaktin është i plotë, e pranon atë për shqyrtim paraprak.

47. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave vendos kthimin e projektaktit ministrit propozues, vetëm kur:

a) mungon njëri nga dokumentet e përcaktuara në pikën 45 të këtij kreu të rregullores;

b) nuk është respektuar forma dhe përmbajtja e parashikuar në këtë rregullore për përgatitjen dhe hartimin e projektakteve, relacionit shpjegues dhe dokumenteve sipas pikave 19, 20 dhe vijuese të kësaj rregulloreje;

c) projektakti nuk është në pajtim me Kushtetutën, vjen në kundërshtim ose nuk është në harmoni me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e brendshëm;

ç) mangësitë e projektaktit, veçanërisht atyre me përmbajtje voluminoze, nga pikëpamja e teknikës legjislative, janë shumë të dukshme dhe të pranishme gjatë gjithë përmbajtjes së tij.

48. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave mund ta korrigjojë projektaktin në drejtim të teknikës legjislative dhe të terminologjisë së përdorur, por në asnjë rast nuk duhet të cenojë thelbin e tij.

49. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, për qartësimin e aspekteve teknike të përmbajtjes së projektaktit, thërret në konsultë strukturat juridike dhe teknike të ministrisë propozuese.

50. Për projektaktet me rëndësi të veçantë, Kryeministri i vënë në dijeni nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, shqyrton propozimin në bazë të disa kritereve lidhur me urgjencën e propozimit, kërkesën e publikut, plotësimin e objektivave të politikave kombëtare të zhvillimit, mundësisë së zbatimit të shpejtë etj.

Këto projektakte mund të diskutohen në rrethe të gjera, ku mund të përfshihen përfaqësues të institucioneve shtetërore, OJF-ve, ekspertë të institucioneve ose organizatave ndërkombëtare etj.

51. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, kur vëren se ministrat ose drejtuesit e institucioneve të interesuara janë shprehur me shkrim kundër projektaktit, e dërgon projektin për bashkërendim sipas procedurave të parashikuara në kreun e pestë të kësaj rregulloreje.

KREU VII
RENDI I DITËS

52. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, në bazë të projektakteve dhe të çështjeve të paraqitura nga anëtarët e Këshillit të Ministrave, përgatit rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit të Ministrave dhe ia paraqet për miratim Kryeministrit.

53. Si rregull, projektaktet përfshihen në rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit të Ministrave, nëse janë dërguar pranë Sekretarit të Përgjithshëm, të paktën 10 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e Këshillit të Ministrave. Për arsye të motivuara dhe me miratimin paraprak të Kryeministrit, në rendin e ditës përfshihen projektakte të dërguara edhe pas afatit 10 ditor.

54. Rendi i ditës i mbledhjes, së bashku me materialet që do të paraqiten për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, i dërgohet nga Sekretari i Përgjithshëm çdo anëtari të Këshilllit të Ministrave, jo më vonë se 2 ditë përpara datës së caktuar për thirrjen e mbledhjes.

55. Për mbledhjet e jashtëzakonshme rendi i ditës shpërndahet jo më vonë se 2 orë përpara orës së caktuar për mbledhje.

56. Rendi i ditës përmban:

a) Tematikën që do të trajtohet.

b) Datën dhe orën e caktuar për mbledhjen e Këshillit të Ministrave.

c) Listën e titujve të projektakteve që do të shqyrtohen në mbledhje.

ç) Listën e çështjeve dhe të problemeve që do të diskutohen.

57. Rendi i ditës nënshkruhet nga sekretari i Përgjithshëm i Këshilllit të Ministrave.

58. Kryeministri, në kushte dhe rrethana të paparashikuara, mund ta ndryshojë rendin e ditës.

59. Çështjet e rendit të ditës të mbetura pa u shqyrtuar në mbledhjen e radhës së Këshillit të Ministrave kalojnë automatikisht në mbledhjen pasardhëse, me përjashtim të rastit kur Kryeministri vendos ndryshe.

60. Si rregull, shqyrtimi i çështjeve të rendit të ditës së mbledhjeve të Këshillit të Ministrave fillon me shqyrtimin e çështjeve të mbetura nga mbledhjet e mëparshme, kur ka të tilla me përjashtim të rasteve kur drejtuesi i mbledhjes vendos ndryshe.

61. Në njoftimin e rendit të ditës së mbledhjeve të Këshillit të Ministrave, Sekretari i Përgjithshëm vendos shënimin për çështjet e mbetura për shqyrtim nga mbledhjet e mëparshme.

KREU VIII
DISKUTIMI I PROJEKTAKTEVE NË MBLEDHJEN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

62. Drejtuesi i mbledhjes paraqet thelbin e projektaktit, i kërkon ministrit propozues, nëse ka komente lidhur me propozimin e tij dhe më pas fton anëtarët e tjerë të Këshillit të Ministrave për të shprehur mendimin e tyre.

63. Pas përfundimit të diskutimit, drejtuesi i mbledhjes fton ministrat për votimin e projektaktit.

64. Në përfundim të shqyrtimit të projektaktit, Këshilli i Ministrave vendos:

a) miratimin në gjendjen e paraqitur;

b) miratimin me ndryshime;

c) shtyrjen për një shqyrtim të mëvonshëm;

ç) mosmiratimin.

65. Mbledhja e Këshillit të Ministrave regjistrohet në procesverbal me stenografi dhe në rrugë elektronike.

KREU IX
BOTIMI DHE SHPËRNDARJA E AKTEVE

66. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave merr masa për:

a) zbardhjen e të gjitha akteve të Këshillit të Ministrave;

b) rregullimin e akteve të miratuara me ndryshime;

c) nënshkrimin e akteve;

ç) shpërndarjen e tyre në institucionet që kanë detyrime ose lidhje me përmbajtjen e aktit.

67. Sekretari i Përgjithshëm merr masat për botimin e të gjitha akteve normative të Këshillit të Ministrave në Fletoren Zyrtare brenda afateve ligjore, si dhe në organe të tjera botuese, brenda një kohe sa më të shkurtër.

68. Shpërndarja zyrtare e akteve bëhet nën drejtimin e Sekretarit të Përgjithshëm, jo më vonë se dy ditë pas nënshkrimit të tyre.

V E N D I M
Nr.4, datë 27.3.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga:

Thimjo KondiKryetar
Perikli ZahariaAnëtar
Kristaq Ngjela "
Bashkim Caka "
Nikoleta Kita "
Ylvi Myrtja "
Natasha Sheshi "
Agron Lamaj "
Valentina Kondili "
Vladimir Metani "
Vladimir Bineri "
Spiro Spiro "
Evjeni Sinoimeri "
Irma Bala "
Zamir Poda"

në seancën gjyqësore të datës 27.3.2003 morën në shqyrtim çështjen që i përket:

KËRKUES:Juan Kondi, përfaqësuar nga avokat N. Duro
OBJEKTI:Konvertimi i dënimit, në bazë të nenit 283/1 të Kodi Penal ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001
Baza ligjore: Neni 3.3 i Kodit Penal, si dhe neni 2 i ligjit nr.7942, datë 31.5.1995.

Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan, me vendimin nr.111, datë 12.4.2002 ka vendosur:
Rrëzimin e kërkesës së bërë nga i padituri Juan Kondi për një konvertim të ri të dënimit.
Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.215, datë 6.9.2002 ka vendosur:
Lënien në fuqi të vendimit nr.111, datë 12.4.2002 të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.
Kundër vendimit nr.215, datë 6.9.2002 të Gjykatës së Apelit Durrës, ka ushtruar rekurs kërkuesi duke parashtruar këto shkaqe:
Ligji i ri ka fuqi prapavepruese edhe ndaj personave të dënuar.
Masa e dënimit nuk mund të kalojë kufirin maksimal, sipas ligjit shqiptar (neni 516/1 i Kodit të Procedurës Penale)
Neni 11 i ligjit nr.7942, datë 31.5.1995 njeh të drejtën që personat t'i drejtohen gjykatës për pretendimet lidhur me efektet juridike të hyrjes në fuqi të Kodit Penal.
Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.91 Akti, datë 19.2.2003 ka vendosur: Kalimin e çështjes Kolegjeve të Bashkuara për të unifikuar praktikën gjyqësore, duke parashtruar:
a. Cili është kuptimi i nenit 3.3 të Kodit Penal në raport me nenin 7 të Konventës Europiane për të Drejtat Themelore të Njeriut dhe nenit 29/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në themel këto dispozita parashikojnë se, kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, ai që është më favorizuesi është edhe ligji i aplikueshëm për personin që ka kryer veprën penale.
b. Në cilën fazë të procedimit është e aplikueshme kjo dispozitë.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjuan relacionin e anëtarëve Z. Poda e V. Metani,
pasi dëgjuan prokurorin Artur Selmani, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës,
pasi dëgjuan avokatin N.Duro, që kërkoi prishjen e vendimeve dhe pranimin e kërkesës,

V Ë R E J N Ë:

Nga shqyrtimi i akteve që ndodhen në fashikullin e kërkuesit Juan Kondi, rezulton se ai me vendim nr.3014, datë 15.10.1999 të Gjykatës së Athinës (Greqi) është deklaruar fajtor dhe dënuar me 17 (shtatëmbëdhjetë) vjet burgim, për krimin e mbajtjes dhe transportimit të lëndëve narkotike, të kryer në bashkëpunim.

Pasi ky vendim kishte marrë formë të prerë, Gjykata e Shkallës së Parë Fier me vendimin nr.307, datë 27.9.2000, në zbatim të urdhërimeve të parashikuara në dispozitat e neneve 512-516 të Kodit të Procedurës Penale, bëri njohjen e tij, duke e cilësuar veprën e kryer nga i dënuari Juan, me nenin 283/I të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë dhe masën e dënimit e konvertoi në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet burgim, që është edhe maksimumi i dënimit me burgim, që parashikohej për këtë vepër nga kjo dispozitë (neni 283/I i Kodit Penal), para ndryshimeve që ajo ka pësuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001.

Pas transferimit të tij në Shqipëri, i dënuari Juan, ndërsa ishte duke vuajtur dënimin në Institutin e Riedukimit Kosovë, më 6.3.2002 paraqiti kërkesë për uljen e kësaj mase në 10 (dhjetë) vjet burgim, aq sa është maksimumi i parashikuar për këtë vepër nga paragrafi i parë i nenit 283 të Kodit Penal, pas ndryshimeve që iu bënë kësaj dispozite me ligjin e përmendur më lart.

Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan, me vendimin nr.111, datë 12.4.2002, vendosi rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se dispozitat e nenit 3/III të Kodit Penal dhe nenit 2 të ligjit nr.7942, datë 31.5.1995 "Për hyrjen në fuqi të ligjit nr.7895, datë 27.1.1995 "Për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë"" nuk e shtrijnë efektin e tyre pas njohjes së vendimeve penale të huaja, vendim i cili u la në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.215, datë 6.9.2002 të saj, me të njëjtin arsyetim.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë mbrojtësi i kërkuesit, avokat Niko Duro, me të cilin kërkon prishjen dhe ndryshimin e tij, sipas kërkesës, duke parashtruar si shkak uljen që iu bë maksimumit të dënimit nga pesëmbëdhjetë në dhjetë vjet burgim, me ndryshimet që me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, iu bënë dispozitës së nenit 283 të Kodit Penal, në përgjithësi dhe paragrafit të parë të saj, në veçanti, duke paraqitur si argument detyrimin për t'u zbatuar nga gjykata paragrafi i III-të i nenit 3 të Kodit Penal dhe ligji nr.9742, datë 31.5.1995.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nisur nga fakti që pranë kësaj gjykate ndodhen edhe disa kërkesa të tjera të kësaj natyre, çmoi se është vendi që të njehsohet praktika gjyqësore lidhur me kuptimin e përmbajtjes së paragrafit të tretë të nenit 3 të Kodit Penal, e parë kjo në raport me përmbajtjen e nenit 7 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe nenit 29/3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, me vendimin nr.91, datë 19.2.2003 të tij, vendosi kalimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara për t'u unifikuar fakti se në cilën fazë të procedimit është i aplikueshëm paragrafi i tretë i nenit 3 të Kodit Penal.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë duke pasur parasysh kuptimin e vërtetë të përmbajtjes së paragrafit të tretë të nenit 3 të Kodit Penal, qëllimin konkret të ligjvënësit që e miratoi atë, frymën e përgjithshme të përmbajtjes së dispozitës së nenit 3 të Kodit Penal, në lidhje me veprimin në kohë, në përgjithësi të ligjit penal, të marra këto në raport me rrethanat faktike në të cilat është bërë njohja e vendimit penal të huaj, që bën fjalë për deklarimin fajtor dhe dënimin e kërkuesit Juan Kondi, arriti në përfundimin se si vendimi nr.111, datë 12.4.2002 i Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, ashtu edhe vendimi nr.215, datë 6.9.2002 i Gjykatës së Apelit Durrës janë të drejta të bazuara në ligj. Ato gjejnë mbështetje të plotë në rrethanat faktike të çështjes dhe si të tillë duhet të lihen në fuqi.

Në këtë përfundim u arrit, duke u interpretuar nga Kolegjet e Bashkuara kuptimi i përmbajtjes së dispozitës së nenit 3 të Kodit Penal dhe veçanërisht i paragrafit të tretë të saj, parë jo në kuadër vetëm të kësaj dispozite, por në një rrafsh akoma më të gjerë, sikurse është nxjerrja në pah e kuptimit të vërtetë të përmbajtjes së këtij paragrafi në raport me imperativin kushtetues të fuqisë prapavepruese të ligjit favorizues, që buron nga përmbajtja e pikës 3 të nenit 29 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe fryma e përgjithshme e kuptimit të nenit 7 të Konventës Europiane të të Drejtave të

Njeriut.

Nisur nga fakti që ligjvënësi shqiptar në një dispozitë të vetme, sikurse është ajo e nenit 3 të Kodit Penal, ka përcaktuar veprimin e ligjit penal në kohë, jo vetëm në përgjithësi, sipas parimit që askush nuk mund të dënohet për një vepër që sipas ligjit të kohës kur është kryer, nuk përbënte vepër penale, por edhe duke dhënë përjashtimet nga ky parim, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, ka përmbajtja e paragrafëve të dytë dhe të tretë të kësaj dispozite, në të cilat parashikohen përjashtimet nga rregulli i përgjithshëm i veprimit në kohë të ligjit penal dhe brenda tyre, lidhje më të drejtpërdrejtë me këtë çështje, pa dyshim, që ka paragrafi i tretë i saj.

Nga përmbajtja e këtij paragafi, sipas të cilit, kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj, dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale, arrihet në përfundimin se, në rastet kur, ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, është më i disfavorshëm se ligji që është në fuqi në kohën e gjykimit të çështjes penale në ngarkim të personit që e ka kryer atë, gjykatat detyrohen të zbatojnë këtë të dytin d.m.th. ligjin e mëvonshëm, i cili është në fuqi në kohën e gjykimit të çështjes.

Ky detyrim rrjedh nga fakti që, në rastin konkret, ligji i mëvonshëm përmban dispozita, të cilat janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale ose, duke përdorur terminologjinë kushtetuese, duhet thënë se ligji i mëvonshëm është ligj penal favorizues dhe pikërisht për këtë arsye, ai ka fuqi prapavepruese.

Megjithatë, duhet vënë në dukje fakti që fuqia prapavepruese e ligjit penal favorizues, në raport me momentin kohor të zbatimit të tij, nuk është e pakufizuar, pasi ky moment është i kushtëzuar nga faza në të cilën gjendet procedimi penal, që i përket personit të akuzuar për kryerjen e veprës penale, fazë e cila, duke u bazuar në sa u thanë me hollësi më lart, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, arrijnë në përfundimin se nuk mund të jetë tej momentit kohor kur vendimi i dënimit penal të personit të akuzuar, ka marrë formë të prerë, gjë që vlen edhe për personat e dënuar me vendim penal të formës së prerë të gjykatave të huaja penale, sikurse është rasti objekt gjykimi.

Të gjitha çështjet e tjera, që mund të lindin pas këtij momenti, i përkasin një faze tjetër, asaj të ekzekutimit të vendimit penal.

Dihet se ndryshe nga fuqia prapavepruese e ligjit penal, që përfshihet në institutin e veprimit penal në kohë, institut, i cili rregullimin e tij ligjor e gjen në normat e ligjit penal material, faza e ekzekutimit të vendimeve penale rregullohet nga normat e ligjit procedural penal, nocione këto që konfondohen në kërkesën e paraqitur nga mbrojtësi i kërkuesit Juan.

Bazuar në sa u parashtrua me hollësi në pjesët e përparshme të këtij vendimi, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin e përgjithshëm se paragrafi i tretë i nenit 3 të Kodit Penal është i zbatueshëm në procedimet penale të vëna në lëvizje pas hyrjes në fuqi të ligjit favorizues, si dhe në procedimet penale, të cilat, megjithëse janë vënë në lëvizje para hyrjes në fuqi të ligjit favorizues, gjykimi për to nuk ka përfunduar ende me vendim të formës së prerë.

Kështu që, personat, vendimi i dënimit penal për të cilët ka marrë formë të prerë, sikurse është rasti i kërkuesit Juan, nuk mund të përfitojnë nga ligji i mëvonshëm, edhe pse ai mund të jetë favorizues në raport me ligjin penal që u zbatua nga gjykatat në kohën e dënimit të tyre.

I vetmi përjashtim nga ky rregull, në kushtet e zakonshme të zbatimit të Kodit Penal, bëhet vetëm për personat e dënuar me vendim të formës së prerë, kur ligji i ri, veprën për të cilën ata janë deklaruar fajtorë dhe dënuar, nuk e konsideron më vepër penale.

Dhe këtë përjashtim e ka bërë vetë ligjvënësi në paragrafin e dytë të nenit 3 të Kodit Penal, sipas të cilit, ligji i ri që nuk dënon veprën penale ka fuqi prapavepruese dhe në rast se personi është dënuar, ekzekutimi i dënimit nuk mund të fillojë dhe në qoftë se ka filluar, pushon.

Thuhet, "në kushtet e zakonshme të zbatimit të Kodit Penal", pasi ligjvënësi, mbas miratimit të ligjit nr.7895, datë 27.1.1995 "Për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë me dy ligje të veçanta, të miratuara ad`hoc me nr.7942 dhe 7984 të datave, respektivisht, 31.5.1995 dhe 28.7.1995, miratuar për hyrjen në fuqi të Kodit Penal, ka parashikuar shprehimisht që personave të cilët janë dënuar me vendim të formës së prerë për një ose më shumë vepra penale me masa dënimi, për një ose më shumë prej tyre, më të larta sesa maksimumi që parashikon për to Kodi i ri Penal, ju mbetet për secilën prej tyre, ky maksimum (nenet 2 dhe 1 të ligjeve respektive).

Nëpërmjet këtyre dy ligjeve, kanë përfituar vetëm personat që ishin dënuar para hyrjes në fuqi të Kodit të ri Penal, d.m.th. me kodet e mëparshme penale dhe një gjë e tillë ishte jo vetëm e domosdoshme, por edhe e kuptueshme, për shkak të disa ndryshimeve jo pak të rëndësishme, që pësoi instituti juridik i përgjegjësisë penale dhe elemente përbërëse të tij në Kodin e ri Penal, në krahasim me të mëparshmet.

Pikërisht, për këtë shkak, dy dispozitat e përmendura të dy ligjeve që u miratuan për hyrjen në fuqi të Kodit të ri Penal, ashtu sikurse edhe vetë këto dy ligje, për nga përmbajtja dhe qëllimi për të cilin u miratuan, ishin kalimtare. Ato shërbyen, ekskluzivisht, për rregullimin nga pikëpamja ligjore të gjendjes faktike të ndryshimeve që ekzistonin, përsa i takonte maksimumit të masave të dënimit që ishin dhënë nga gjykatat ndaj personave të dënuar para hyrjes në fuqi të Kodit të ri Penal për vepra, të cilat, edhe sipas këtij të fundit, vazhdojnë të konsiderohen vepra penale dhe nuk mund të zbatohen edhe në raste të tjera, sikurse, pa të drejtë, pretendohet në rekursin e paraqitur nga mbrojtësi i caktuar nga kërkuesi Juan.

Po kështu, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, çmojnë se duhet të vihet në dukje edhe fakti që, veç sa u përmendën në pjesën e mëparshme të këtij vendimi, pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit Juan për uljen e masës së dënimit nga pesëmbëdhjetë në dhjetë vjet burgim, nuk qëndron edhe për shkak se, megjithëse maksimumi i dënimit me burgim, që parashikohet nga paragrafi i parë i nenit 283 (të ndryshuar) të Kodit Penal, është jo pesëmbëdhjetë, që e kishte dispozita e pandryshuar, por dhjetë vjet burgim, bazuar në faktin që, sipas vendimit penal nr.3014, datë 15.10.1999 të Gjykatës së Athinës (Greqi), vepra penale e mbajtjes dhe e transportimit të lëndëve narkotike është kryer në bashkëpunim, pas ndryshimeve që iu bënë dispozitës së nenit 283 të Kodit Penal, vepra e tij nuk do të cilësohej me paragrafin e parë, por me paragrafin e dytë (i cili bashkëpunimin nuk e parashikon si rrethanë thjesht të anës objektive të figurës së kësaj vepre penale, por edhe si rrethanë cilësonjëse), në të cilin kufijtë e dënimit variojnë nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim d.m.th. janë më të disfavorshme (më të rënda), në raport me marzhet e dënimit, nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet, që parashikonte kjo dispozitë e Kodit Penal, para ndryshimeve që iu bënë asaj me ligjin e përmendur disa herë më lart.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 441/a të Kushtetutës dhe 441 pika "a" të Kodit të Procedurës Penale,

V E N D O S Ë N:

Lënien në fuqi të vendimit nr.215, datë 6.9.2002 të Gjykatës së Apelit Durrës. Ky vendim është unifikues. Një kopje e tij të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M
Nr.31, datë 14.4.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga:

Thimjo KondiKryetar
Perikli ZahariaAnëtar
Kristaq Ngjela “
Ylvi Myrtja “
Agron Lamaj “
Natasha Sheshi “
Nikoleta Kita “

Spiro Spiro “
Artan Hoxha “
Irma Bala “
Valentina Kondili “
Vladimir Metani “
Bashkim Caka “
Evjeni Sinoimeri “

në seancat gjyqësore të datave 26.3.2003 dhe 14.4.2003 morën në shqyrtim çështjen nr.38 që i përket:

PADITËS:PAULIN CUNI, i datëlindjes 1968, lindur dhe banues në Theth, Dukagjin Shkodër, përfaqësuar nga avokat Haki Kraja.

I PADITUR:DREJTORIA E POLICISË SË QARKUT SHKODËR, në mungesë

OBJEKTI I PADISË:Anulim i urdhrit nr.298 datë 22.4.2002 të Drejtorit të Policisë së Qarkut Shkodër

Baza ligjore:Nenet 31 e 32 të Kodit të Procedurës Civile.
Neni 32/5 i ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”.

Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër, me vendimin nr.1068, datë 2.10.2002 ka vendosur:

“Anulimin tërësisht të urdhërit nr.298, datë 22.4.2002 të Drejtorit të Policisë së Qarkut Shkodër.

Detyrimin e të paditurit, Drejtoria e Policisë së Qarkut Shkodër të rimarrë në polici në rolin bazë, paditësin Paulin Cuni, duke i paguar atij pagën që nga data 5.4.2002 deri në datën e rikthimit në punë”.

Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr.329, datë 25.11.2002 ka vendosur:

“Ndryshimin e vendimit nr.1068 datë 2.10.2002 të Gjykatës së Rrethit Shkodër dhe rrëzimin e padisë”.

Kundër vendimit nr.329, datë 25.11.2002 të Gjykatës së Apelit Shkodër ka ushtruar rekurs paditësi Paulin Cuni, i cili parashtron:

Gjykata e apelit ka dhënë një vendim haptazi në kundërshtim me ligjin.

Vendimi i gjykatës së apelit është pa arsyetim.

Gjykata e apelit nuk është shprehur për themelin e çështjes, nëse urdhri i lirimit nga detyra është i ligjshëm apo jo.

Gjykata e apelit ka lënë të pazgjidhur konfliktin.

Nuk është e vërtetë se nuk është kërkuar e drejta e pagës, e drejta e pagës është kërkuar me padi dhe gjatë gjykimit, si dhe në kërkesat përfundimtare.

Kur akti administrativ vjen në kundërshtim me ligjin, gjykata duhet të rregullojë pasojat.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjuan relacionin e gjyqtarëve Ylvi Myrtja dhe Kristaq Ngjela, avokatin e paditësit, i cili kërkoi prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë ose kthimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e apelit, në mungesë të palës së paditur, si dhe pasi biseduan çështjen në tërësi,

V Ë R E J N Ë:

Paditësi Paulin Cuni ka qenë efektiv i Komisariatit të Policisë Shkodër me detyrë kujdestar në postën kufitare të nënseksionit të Policisë Kufitare të këtij komisariati.

Me propozimin nr.144, datë 16.4.2002 të Komisariatit të Policisë Shkodër dhe vendim të Këshillit Emërues të Policisë së Qarkut Shkodër, Drejtori i Policisë së Qarkut Shkodër e ka

përjashtuar nga policia paditësin, me urdhrin nr.298, datë 22.4.2002. Në urdhër thuhet: "Nënoficer Paulin Kol Cuni, deri tani me detyrë kujdestar-magazinier në PPK Theth në nënseksionin e Policisë Kufitare në Komisariatin e Policisë Shkodër, të përjashtohet nga policia me motivacionin "Për mosparaqitje në detyrë mbi shtatë ditë". Marrëdhëniet administrative financiare t'i ndërpriten më datën 5.4.2002".

Urdhrin nr.298, datë 22.4.2002 të Drejtorit të Policisë së Qarkut Shkodër, paditësi e ka kundërshtuar në gjykatë. Në kërkesëpadinë që ka paraqitur në Gjykatën e Shkallës së Parë Shkodër, paditësi pretendon:

Urdhri nr.298, datë 22.4.2003 i Drejtorit të Policisë së Qarkut Shkodër nuk është i bazuar në ligj e në prova.

Nuk është e vërtetë që të kem munguar në detyrë mbi shtatë ditë.

Kërkimet paditësi i ka bazuar në nenet 31 e 32 të Kodi të Procedurës Civile, në nenin 12 të ligjit nr.1188, datë 10.8.1995 dhe nenit 32/5 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit".

Gjatë gjykimit, përveç pyetjes së dëshmitarëve, gjykata ka administruar propozimin nr.144, datë 16.4.2002 të Shefit të Komisariatit të Policisë Shkodër, propozimin e datës 18.4.2002 të Këshillit Emërues të Qarkut të Policisë, urdhrin nr.298, datë 22.4.2002 të Drejtorit të Policisë të Qarkut Shkodër, listë prezencën e efektivit të PPK Theth për periudhën 1.4.2002 deri më 15.4.2002 dhe trembëdhjetë fletë të shkëputura nga libri i shërbimit.

Paditësi ka kërkuar: "Anulimin e urdhrit nr.298, datë 22.4.2002, rikthimin në punë dhe pagesën deri në rimarrjen në punë" me arsyetimin se pretendimi i ngritur prej tij se nuk ka munguar më shumë se shtatë ditë është provuar si nga shpjegimet e dëshmitarëve, ashtu edhe nga provat e paraqitura nga pala e paditur si libri i shërbimit PPK Theth, praktika disiplinore dhe vlerësimi, që i është bërë punës së tij.

Në përfundim të gjykimit Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër ka vendosur anulimin e urdhrit nr.298, datë 22.4.2002, objekt gjykimi, detyrimin e të padituri të rimarrë në punë paditësin, duke i paguar pagën nga data 5.4.2002 deri në datën e kthimit në punë me këtë arsyetim:

Gjykata krijon bindjen se nuk është e vërtetë që paditësi Paulin Cuni nuk është paraqitur në detyrë mbi shtatë ditë, për pasojë urdhrin nr.298, datë 22.4.2002 të Drejtorit të Policisë së Qarkut Shkodër për përjashtimin nga policia të paditësit Paulin Cuni e çmon të pabazuar në ligj, pasi nuk jemi para asnjë prej rasteve të përjashtimit nga policia, të parashikuar nga neni 20 pika 3/a e ligjit nr.8553, datë 25.11.1999.

Në nenin 32/5 të ligjit "Për Policinë e Shtetit" parashikohet e drejta e të ndëshkuarve për t'u ankuar drejtpërdrejt në gjykatë, ndërsa në nenin 68/1 të të njëjtit ligj parashikohet që: "Trajtimi i punonjësve të policisë deri në plotësimin e akteve normative, të parashikuara në këtë ligj, bëhet sipas statusit të ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë".

Ligji nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit" nuk tregon se çfarë mund të vendosë gjykata kur e gjen të drejtë ankimin e të ndëshkuarve, siç është rasti i paditësit Paulin Cuni, por referon tek statusi i ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Në ligjin nr.8670, datë 26.10.2000 "Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", neni 28 pika 3 thuhet: "Kur akti i shfuqizuar nga gjykata ka të bëjë me nxjerrjen në rezervë ose me lirimin e ushtarakut nga Forcat e Armatosura, ai ka të drejtë të rikthehet në detyrën e mëparshme ose në një detyrë tjetër të njëjtë me atë të mëparshmen".

Gjykata çmon se urdhri nr.298 është akt administrativ, që nuk bën pjesë në aktet administrative të parashikuara nga neni 326 i Kodit të Procedurës Civile, ndaj të cilëve nuk mund të ngrihen padi në gjykatë, prandaj konform nenit 325 të Kodit të Procedurës Civile e gjen të drejtë kërkesën e paditësit Paulin Cuni për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga urdhri objekt gjykimi.

Në përfundim, gjykata çmon se duhet të anulohet urdhri nr. 298 i Drejtorit të Policisë së Qarkut Shkodër, datë 22.4.2002 dhe paditësi Paulin Cuni të rikthehet në polici, në rolin bazë, duke u dëmshpërblyer me shumën e lekëve të barabartë me pagën që nga dita e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare 5.4.2002 deri më datën e rifillimit të detyrës në rolin bazë në polici.

Vendimi i dhënë nga gjykata e rrethit është apeluar nga Drejtori i Policisë së Qarkut Shkodër.

Në apelim pretendohet:

Urdhri objekt gjykimi, që i është anuluar nga gjykata e shkallës së parë, është bazuar në dokumentacionin që është paraqitur nga nënseksioni i Policisë Kufitare të Komisariatit Shkodër.

Në relacionin sqarues të përpiluar nga kapiteni i parë Ndrek Brushtulli, me detyrë komandant i PPK Theth, ku shërbente paditësi dhe e sigluar nga shefi i nënseksionit të Policisë Kufitare të Komisariatit Shkodër, kapiten i parë Rakip Hasa shprehet qartë se deri më datën 12.4.2002 nga paditësi kishte mosparaqitje në punë për nëntë ditë.

Për këto mungesa të paditësit janë njoftuar çdo ditë komandanti i PPK Theth dhe shefi i nënseksionit të Policisë Kufitare nga efektivi i policisë në postë dhe komunikimi me radio.

Në seancën gjyqësore të datës 27.9.2002 kemi kërkuar riçeljen e hetimit gjyqësor për marrjen dhe një herë në pyetje të policëve të PPK Theth, Nikolin Guri, Arben Shkëmbi, Besnik Qarku dhe Lush Blinishta, por kjo kërkesë e jona nuk u pranua padrejtësisht nga gjyqtari.

Ripyetja e katër policëve të mësipërm është e domosdoshme se në librin e planizimit të shërbimit 24 orësh të PPK Theth, është bërë fallsifikim duke u plotësuar pas datës 14.4.2002. Kjo vërtetohet nga ndryshimet në shkrim, si dhe nga ripohimet e policëve.

Më datën 25.11.2002, gjykata e apelit pasi ka dëgjuar paditësin dhe avokatin e tij në mungesë të palës së paditur ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë me arsyetimin:

Në vendimin nr.37, datë 29.5.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë është mbajtur ky qëndrim:

"Megjithatë me anën e ankimit në gjykatë ushtaraku apo punonjësi i policisë ... nuk mund të realizojë rikthimin në detyrën që ka pasur edhe kur është larguar prej saj për shkaqe të përligjura, por mund të realizojë të drejtën për t'u kompensuar financiarisht për dëmet e shkaktuara nga ndërprerja e kontratës së shërbimit .... nëpunësit publikë të kësaj kategorie në asnjë rast nuk mund të mbrohen me padi për rikthimin në detyrën që kishin". Në këtë kuptim kthimi në detyrë si polic i paditësit nga gjykata është i gabuar.

Paditësi në ngritjen e padisë nuk ka kërkuar dëmshpërblimin për kohën e qëndrimit pa punë, kështu që gjykata e apelit në bazë të nenit 6 të Kodit të Procedurës Civile nuk mund të shprehet për këtë, megjithëse largimin nga puna të paditësit Paulin Cuni, gjykata e ka quajtur të padrejtë.

Me vendimin e datës 22.1.2003 Kryetari i Gjykatës së Lartë ka vendosur që rekursi i paraqitur nga paditësi Paulin Cuni kundër vendimit të gjykatës së apelit të shqyrtohet në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për të unifikuar praktikën gjyqësore për faktin se vazhdojnë të mbahen qëndrime të ndryshme nga gjykata të shkallëve të ndryshme.

Në vendimin për kalimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë thuhet:"… në nenet 29 dhe 32 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit" u njihet vetëm e drejta e ankimit në gjykatë, pa u shprehur për të drejtën e rikthimit në punë. Në pikën 3 të nenit 28 të ligjit nr.8670, datë 26.10.2000 "Për gradat dhe karrierën e ushtarakëve në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë" thuhet: "Kur akti i shfuqizuar nga gjykata ka të bëjë me nxjerrjen në rezervë ose me lirimin e ushtarakut nga Forcat e Armatosura, ai ka të drejtë të rikthehet në detyrën e mëparshme ose në një detyrë tjetër të njëjtë me atë të mëparshmen". Gjykatat konsiderojnë ushtarak edhe punonjësin e policisë, për këtë arsye zbatojnë ligjin për ushtarakët.

Kolegjet e Bashkuara çmojnë se një pjesë e pretendimeve të ngritura në rekurs qëndrojnë. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi nga gjykata e apelit është zbatuar keq ligji.

Objekti i mosmarrëveshjes i pretenduar nga paditësi ka qenë ligjshmëria e urdhrit nr.298, datë 22.4.2002 të Drejtorit të Policisë së Qarkut Shkodër. Sipas paditësit, ky urdhër nuk është i bazuar në ligj e në prova. Gjykata e shkallës së parë ka pranuar pretendimet e paditësit, ka anuluar urdhrin dhe detyruar të padituri të rimarrë në punë paditësin. Gjykata e apelit nuk është shprehur nëse urdhri është i ligjshëm apo jo. Pa u shprehur për themelin gjykata e apelit ka rrëzuar padinë, si të pabazuar në ligj e në prova me arsyetimin se paditësi nuk mund të rikthehej në punë.

Gjykata e apelit e kishte për detyrë të kryente një hetim gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm e në përputhje me ligjin (neni 14 i Kodit të Procedurës Civile) për të sqaruar nëse urdhri i Drejtorit të Policisë së Qarkut Shkodër është në pajtim ose në kundërshtim me ligjin. Në zbatim të kësaj detyre, gjykata e apelit mund të përsëriste tërësisht apo pjesërisht hetimin gjyqësor me të drejtën për të marrë

edhe prova të reja (neni 465 i Kodit të Procedurës Civile). Duke mos u shprehur për ligjshmërinë e urdhrit të Drejtorit të Policisë, gjykata e apelit ka lënë pa zgjidhur mosmarrëveshjen objekt gjykimi (neni 16 i Kodit të Procedurës Civile).

Për pasojë, vendimi i gjykatës së apelit duhet të prishet dhe çështja duhet të dërgohet përsëri për rishqyrtim në gjykatën e apelit. Meqenëse gjykata e apelit nuk e ka shqyrtuar themelin e çështjes, ajo është e detyruar ta rigjykojë edhe një herë këtë çështje dhe të verifikojë, nëse është shkelur apo nuk është shkelur ligji nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Shkodër. Në zbatim të dispozitave që cituam më sipër gjykata e apelit duhet të shqyrtojë si faktin dhe ligjin.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse ka ekzistuar një "kontratë e shërbimit publik". Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konkludojnë dhe udhëzojnë (neni 486 i Kodit të Procedurës Civile) se kur "kontrata e shërbimit publik" zgjidhet dhe zgjidhja e kësaj kontrate është në përputhje me ligjin, nuk shtrohet për diskutim asnjë problem. Probleme lindin kur zgjidhja e kontratës është në kundërshtim me ligjin. Kur kontrata zgjidhet në kundërshtim me ligjin shtrohet për diskutim:

A mund të vendoset gjyqësisht rikthimi në punë i të larguarit nga puna apo në raste të tilla vetëm do të dëmshpërblehet për pushimin e padrejtë nga puna?

Dëmshpërblimi duhet të kërkohet në mënyrë të shprehur apo mjafton kundërshtimi i zgjidhjes së kontratës, që të shqyrtohet edhe dëmshpërblimi?

Si do të llogaritet dëmshpërblimi për pushimet e padrejta nga puna?

Duhet të kemi parasysh se për punonjësit që merren në radhët e policisë ndodhemi përpara një marrëdhënie kontraktore në formën e kontratës së shërbimit publik. Kushtet e kontratës parashikohen në ligjin "Për Policinë e Shtetit". Në këtë ligj parashikohet statusi i punonjësit të policisë (neni 15), pranimi në radhët e policisë (neni 16), emërimi dhe lirimi (neni 19), largimet dhe përjashtimet (neni 20), masat disiplinore (neni 29) dhe ankimet për largimin ose përjashtimin nga policia (neni 32). Paditësi është larguar nga policia në bazë të germës "b" të pikës "3" të nenit 20. Në këtë dispozitë thuhet: "Punonjësi i policisë përjashtohet nga policia, kur nuk paraqitet në detyrë, pa shkaqe të arsyetuara mbi 7 ditë". Me këtë arsyetim është zgjidhur "kontrata e shërbimit publik" nga Drejtori i Policisë së Qarkut Shkodër.

Në lidhje me zgjidhjen e kësaj kontrate, gjykata e shkallës së parë arsyeton: Ligji "Për Policinë ë Shtetit" nuk tregon se çfarë mund të vendosë gjykata kur e gjen të drejtë ankimin e të ndëshkuarve, siç është rasti i paditësit, por të referon tek statusi i ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Sipas gjykatës referenca del nga neni 68/1 i ligjit "Për Policinë e Shtetit" në të cilin thuhet: "Trajtimi i punonjësve të policisë deri në plotësimin e akteve normative, të parashikuara në këtë ligj bëhet sipas statusit të ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë".

Për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi, gjykata e shkallës së parë nuk i është referuar ligjit nr.7978 datë 26.7.1995 "Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", por ligjit nr.8670, datë 26.10.2000 "Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë". Dispozitat e këtij ligji nuk janë të detyrueshme për punonjësit e policisë, ato janë të zbatueshme vetëm për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Në bazë të Kushtetutës së Shqipërisë (neni 168/1), punonjësit e policisë nuk bëjnë pjesë në Forcat e Armatosura. Në nenin 15/1 të ligjit "Për Policinë e Shtetit" është sanksionuar: "Statusi i punonjësit të policisë rregullohet me këtë ligj …".

Për të kuptuar më saktë statusin e punonjësve të policisë duhet t'i referohemi patjetër nenit 1 dhe 2 të ligjit "Për Policinë e Shtetit" ku është përcaktuar: "Policia e Shtetit, në vijim e shprehur "Policia", është institucion i administratës shtetërore të Republikës së Shqipërisë, në varësi të Ministrit të Rendit Publik, që ka për mision të mbrojë rendin dhe sigurinë publike, si dhe të garantojë zbatimin e ligjit … Statusi i policisë, i përcaktuar në këtë ligj, nuk ndryshon edhe në kushtet e gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme apo të rasteve të fatkeqësive natyrore".

Ndërsa neni 1 i ligjit "Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë" përcakton: "Ky ligj përcakton kriteret dhe autoritetin për pranimin në gradë dhe në karrierë, përgjegjësitë që rrjedhin nga karakteri i veçantë i detyrës dhe i shërbimit ushtarak dhe ndërprerjen e karrierës për ushtarakët e Forcave të Armatosura".

Referimi tek ky ligj është i gabuar. Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj…" (neni 16 i Kodit të Procedurës Civile). Për gjykatën që do të rigjykojë këtë çështje janë të detyrueshme të zbatohen dispozitat ligjore të ligjit të posaçëm për Policinë e Shtetit.

Sipas ligjit "Për Policinë e Shtetit", kur zgjidhet kontrata e shërbimit publik nuk shtrohet fare për diskutim problemi i mundësisë së vendosjes në rrugë gjyqësore të detyrimit për rilidhjen e kësaj kontrate, nëse konkludohet se është zgjidhur në mënyrë të paligjshme. Rilidhja e kontratës së shërbimit publik mund të bëhet vetëm me vullnetin e palëve. Kur njëra nga palët nuk jep pëlqimin, kontrata nuk mund të rilidhet. Ligji për policinë nuk ka ndonjë urdhërim për rimarrjen në punë. Meqenëse kemi një ligj të posaçëm, siç është ligji për policinë, edhe mosmarrëveshja objekt gjykimi duhet të zgjidhet në përputhje me këtë ligj (neni 16 i Kodit të Procedurës Civile).

Ligji për policinë nuk e njeh rikthimin në punë. Ky ligj nuk i ka dhënë të drejtën gjykatës për të rikthyer në punë punonjësit e larguar nga radhët e policisë.

Rikthimi në punë është në diskrecionin e administratës së policisë dhe ky diskrecion nuk i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor. Rikthimi ose jo i të larguarit nga puna është në çmimin e administratës së policisë në Qarkun e Shkodrës. Vetëm Drejtoria e Policisë së Qarkut Shkodër mund ta rimarrë në punë paditësin.

Nga ana tjetër, punëdhënësi apo një organ administrativ më i lartë nga varet punëdhënësi, mund ta çmojë që ta rimarrë punëmarrësin në punën e mëparshme apo në një punë tjetër të përafërt me të. Në raste të tilla ai mund të bindet për paligjshmërinë e largimit nga puna dhe të vendosë rikthim të plotë të të drejtave të të punësuarit.

Si përfundim, me anë të ankimit në gjykatë punonjësi i policisë, ashtu si dhe një numër tjetër punonjësish publikë që kanë detyra të caktuara shërbimi ndaj shtetit, për shkak të të cilave veprojnë si përfaqësues të shtetit për mbrojtjen e interesave të tij, nuk mund të realizojnë gjyqësisht rikthimin në detyrën që kanë pasur, edhe në qoftë se provohet se janë larguar prej saj pa shkaqe të përligjura.

Në këto raste e drejta e rikthimit në punë nuk konsiderohet një e drejtë themelore, në kuptimin që u jep të drejtave të tilla Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Europiane e të Drejtave te Njeriut, mbrojtja gjyqësore e të cilave është e garantuar. Sidoqoftë, ligjvënësi nuk ka pengesë që të miratojë një ligj për t'i dhënë mbrojtje gjyqësore edhe kësaj të drejte. Megjithatë, deri më sot, nuk e ka çmuar të sigurojë e të garantojë një mbrojtje të tillë. Aktualisht ligji "Për Policinë e Shtetit" nuk siguron një mbrojtje më të madhe se standardi minimum i konventës. Gjykatës që shqyrton këto mosmarrëveshje me këtë ligj nuk i zgjerohet hapësira, përkundrazi i ngushtohet. Sa më lart është një qëndrim konseguent i Gjykatës së Lartë, i cili është në pajtim me jurisprudencën (case law) të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, të cituar edhe në vendime të tjera. Përsërisim se në vendimin e Gjykatës së Strasburgut, në çështjen Pellegrin kundër Francës, kjo gjykatë, ndër të tjera, arsyeton si më poshtë:"… në sektorin publik të çdo vendi disa poste kanë të bëjnë me përgjegjësi, që janë në interesin e përgjithshëm ose me pjesëmarrje në ushtrimin e pushteteve që jepen prej të drejtës publike. Mbajtësit e posteve të tilla në këtë mënyrë përdorin një pjesë të pushtetit sovran të shtetit. Për rrjedhojë, shteti ka një interes legjitim për të kërkuar prej këtyre nëpunësve një detyrim të veçantë besimi dhe besnikërie. Nga ana tjetër, në lidhje me postet e tjera, të cilat nuk kanë këtë aspekt të "administrimit publik", nuk ka interes të tillë …..

Për rrjedhojë, gjykata vendos që të vetmet mosmarrëveshje që përjashtohen prej përmbajtjes së nenit 6/1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut janë ato që ngrihen nga nëpunësit publikë, detyrat e të cilëve tipizojnë aktivitetet specifike të shërbimit publik, për aq sa ky i fundit vepron si depozitar i autoritetit publik, që është përgjegjës për mbrojtjen e interesave të përgjithshme të shtetit ose të autoriteteve të tjera publike. Një shembull i shprehur qartë i aktiviteteve të tilla është rezervuar për forcat e armatosura dhe policinë …."

E drejta e rikthimit në punë nuk gëzon mbrojtje gjyqësore, ndërsa e drejta e dëmshpërblimit është një e drejtë që gëzon mbrojtje. Pala që dëmtohet nga një pushim i padrejtë nga puna gëzon të drejtën e dëmshpërblimit në rrugë gjyqësore.

Një konkluzion i tillë del edhe nga neni 44 i Kushtetutës sipas të cilit: "Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një

akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore".

Ndërsa Kodi i Punës shprehet qartë se çfarë bëhet kur zgjidhet në mënyrë të padrejtë kontrata e punës (neni 146/3 i Kodit të Punës), në ligjin "Për Policinë e Shtetit" thuhet: "Dëmi material i shkaktuar zhdëmtohet sipas akteve normative përkatëse" (neni 29/2). Mungesa e akteve normative nuk mund të shërbejë si argument për të refuzuar shqyrtimin e çështjes objekt gjykimi (neni 1/2 i Kodit të Procedurës Civile).

Zgjidhja e kontratës së shërbimit publik pa shkaqe të arsyeshme sjell si pasojë përgjegjësinë e punëdhënësit të zhdëmtojë punëmarrësin për dëmet e pësuara nga zgjidhja e kontratës, duke e vënë atë në atë gjendje pasurore që do të ishte po të mos ishte larguar nga radhët e policisë.

Gjykata që shqyrton largimin e policit nga puna nuk shqyrton kontratën e punësimit. Ajo është zgjidhur në mënyrë të njëanshme. Ajo dëmshpërblen palën që është dëmtuar, në qoftë se gjatë gjykimit do të rezultojë se zgjidhja e njëanshme e kontratës është e pabazuar në ligj. Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, edhe në çështjen Niegel kundër Francës pranon se paditë që lidhen me pagat apo përfitimet e tjera financiare nuk janë të lidhura domosdoshmërisht me paditë për rikthimin në detyrë … Pagat, pensionet dhe përfitime të tjera sipas kontratës së shërbimit publik, nuk janë të lidhura me ndonjë pushtet diskrecional. Diskrecioni mund të ushtrohet vetëm në lidhje me rekrutimin ose mbarimin e kontratave publike, por jo për rrjedhojat ekonomike që vijnë prej tyre.

Këto të drejta të karakterit privat (që nuk lidhen me të drejtën publike), mund të mbrohen në gjykatë si të gjitha të drejtat e tjera civile.

I larguari nga radhët e policisë ka të drejtë të kërkojë vetëm shpërblimin e dëmit, pasi rikthimi në punën e mëparshme mund të bëhet vetëm me vullnetin e punëdhënësit. Për sa kohë punëdhënësi nuk ka vullnet për ta rimarrë në punë, kontrata e shërbimit publik nuk mund të rilidhet. Kontrata e shërbimit publik, duke qenë veprim juridik duhet të jetë rezultat i shprehjes së vullnetit të lirë të palëve. Por vlen të theksohet se pala që ka zgjidhur kontratën pa shkaqe të arsyeshme detyrohet t'i japë punëmarrësit një dëmshpërblim.

Në lidhje me sa u argumentua më sipër Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se nuk është e nevojshme të kërkohet në mënyrë të shprehur dëmshpërblimi. Për rastet kur punonjësit e policisë kundërshtojnë zgjidhjen e kontratës së shërbimit civil, mjafton të kundërshtohet akti me të cilin është zgjidhur kontrata dhe gjykata duhet të marrë në shqyrtim edhe pasojat që vijnë nga zgjidhja e paligjshme e kontratës d.m.th. dëmshpërblimin. Megjithatë, si në çdo rast tjetër, i takon paditësit barra për të provuar sasinë e dëmit që i është shkaktuar.

Kur kontrata e punës zgjidhet pa shkaqe të arsyeshme, punëdhënësi duhet të paguajë një shumë të hollash që të përfaqësojë dëmin e pësuar. Shpërblimi i dëmit ka për qëllim të zëvendësojë dëmin e pësuar nga zgjidhja e padrejtë e kontratës së punës, prandaj ky zhdëmtim duhet të jetë i plotë.

Dëmshpërblimi në vend të rikthimit në punë do të thotë se"shkaktuesi i dëmit" do të paguajë një shumë të hollash që do ta vendosë të larguarin nga puna në atë gjendje pasurore që do të ishte, po të mos ishte larguar nga puna. Parimi i shpërblimit të plotë të dëmit është një parim themelor. Shpërblimi i plotë i dëmit do të thotë që sasia e shpërblimit të jetë në pajtim me masën e dëmit të shkaktuar.

Largimi nga puna është i lidhur me ndërprerjen e pagës. Mosmarrja e pagës ndikon në kushtet materiale të jetës së punonjësit dhe familjes së tij. Pagat e humbura ose të pakësuara duhet të shpërblehen. Në këto raste dëmshpërblimi duhet për të përballuar kushtet materiale të jetës për aq kohë, brenda së cilës çmohet se punëmarrësi mund të gjejë një punë tjetër. Gjykata në çdo rast, sipas diskrecionit të saj, me vendimin që jep bën një vlerësim paraprak të dëmit të pësuar nga punëmarrësi. Ndërsa Kodi i Punës në raste analoge ka përcaktuar si vlerë maksimale të dëmshpërblimit pagën e një viti, për këtë kategori të punësuarish nuk kemi të fiksuar në ligj të posaçëm ndonjë kriter apo kufi vlerësimi. Për rrjedhojë, është në diskrecionin e gjykatës për të vendosur një masë të arsyeshme dëmshpërblimi, duke u nisur nga rrethanat konkrete të çdo rasti të veçantë.

Në lidhje me masën e dëmshpërblimit që pretendon, paditësi ka detyrimin që në përputhje me ligjin, të provojë faktet, mbi të cilat bazon pretendimet e tij (nenet 8, 12 e 213 e vijues të Kodi i Procedurës Civile).

Në rigjykim, gjykata e apelit duhet të verifikojë, nëse kontrata e shërbimit është zgjidhur në pajtim apo në kundërshtim me ligjin. Në funksion të përfundimeve që do të dalin pas hetimit gjyqësor, do të zgjidhen edhe problemet e shtruara për diskutim.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 485/c të Kodit të Procedurës Civile,

V E N D O S Ë N

Prishjen e vendimit nr.329, datë 25.11.2002 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Shkodër me tjetër trup gjykues.

Ky vendim për njehsimin e praktikës gjyqësore të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I GJYQTARËVE NË PAKICË

Pakica ka mendimin se vendimi i marrë nga shumica e gjyqtarëve në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë duke e dërguar çështjen me paditës Paulin Cuni për rishqyrtim në gjykatën e apelit dhe arsyetimi se gjykata nuk ka të drejtë të marrë vendim për kthimin në punë të një punonjësi të policisë, edhe kur ajo konstaton se është përjashtuar padrejtësisht nga detyra nuk janë të bazuara në ligj dhe nuk mbron të drejtat e njohura me ligj për punonjësit e policisë.

Nga aktet që ndodhen në dosje, rezulton se paditësi Paulin Cuni ka qenë polic efektiv i komisariatit në nënseksionin e Policisë Kufitare në PPK Theth dhe me propozim të Këshillit Emërues të Qarkut Shkodër, me urdhërin nr. 298, datë 22.4.2002 të Drejtorit të Policisë së Qarkut, është përjashtuar nga detyra me arsyetimin se nuk është paraqitur në detyrë mbi 7 ditë.

Mbi padinë e Paulin Cunit me objekt anulimin e urdhrit të mësipërm, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, pasi ka shqyrtuar çështjen dhe ka arritur në përfundimin se nuk është e vërtetë që paditësi nuk është paraqitur në detyrë mbi 7 ditë e se për pasojë urdhri për përjashtimin e paditësit nga detyra nuk qëndron, se nuk ndodhemi para asnjë nga rastet që parashikon neni 20 pika 3 e ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit", që bën fjalë për largimet dhe përjashtimet nga policia, ka anuluar urdhrin duke vendosur dhe detyrimin e të padituri të rimarrë në polici në rolin bazë paditësin Paulin Cuni.

Vendimi i gjykatës së rrethit është ndryshuar me vendim të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe është rrëzuar padia me arsyetimin se me anë të ankimit në gjykatë, ushtaraku apo punonjësi i policisë, nuk mund të realizojë kthimin në detyrën e mëparshme, arsyetim ky që pranohet edhe nga shumica në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Duke pasur parasysh trajtimin e bërë para gjykatës shtrohen si probleme:

a) nëse punonjësi i policisë që përjashtohet nga policia, ka të drejtë të ankojë urdhrin përkatës në gjykatë e të kërkojë anulimin e tij kur pretendon se është i padrejtë?

b) gjykata që shqyrton çështjen a ka të drejtë të vendosë për kthimin e policit në detyrën e mëparshme?

Për t'iu dhënë përgjigje këtyre pyetjeve është e nevojshme që në radhë të parë, t'i drejtohemi Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë duke përmendur nenin 42 të saj, sipas të cilit "Kushdo për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ... ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj". Sikurse shihet, Kushtetuta shprehet për rivendosjen e të drejtave ligjore të cenuara dhe në këtë aspekt, (duke pasur parasysh dhe problemet që do trajtohen më poshtë) pakica ka mendimin se edhe urdhrat për përjashtimin e policit nga policia i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor dhe për pasojë, është në kompetencën e gjykatës që shqyrton çështjen që të nxjerrë përfundime për

ligjshmërinë e tyre e nëse i gjen të kundërligjshme, të vendosë për shfuqizimin e tyre.

Në bazë të nenit 168/1 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, punonjësit e policisë nuk bëjnë pjesë në Forcat e Armatosura e veprimtaria e tyre ushtrohet në bazë të ligjit "Për Policinë e Shtetit". Megjithëse edhe në bazë të këtij ligji, policia është institucion i administratës shtetërore, duhet pranuar se çdo punonjës policie gëzon mbrojtjen e të drejtave të tij në bazë të kritereve të përcaktuara në ligj.

Sipas nenit 20 të ligjit "Për Policinë e Shtetit", punonjësi i policisë largohet nga policia (përcaktohen rastet) apo përjashtohet nga policia, kur thyen rëndë disiplinën, kur kryen thyerje të përsëritura të disiplinës, kur nuk paraqitet në detyrë pa shkaqe të arsyeshme mbi 7 ditë (neni 20/3/b) etj. Njëkohësisht, në pikën 4 të këtij neni, parashikohet e drejta e ankimit për largimin apo përjashtimin nga policia në përputhje me kriteret e caktuara në kreun 5 të ligjit e në nenin 31 të këtij kreu, përsëritet se në çdo rast punonjësit të policisë, ndaj të cilit është marrë masa disiplinore, i lind e drejta për të bërë ankim me shkrim te titullari i organit dhe në nenin 32 të ligjit parashikohen të drejtat e komisionit disiplinor që shqyrton ankesat disiplinore, të drejtën që ka ky komision që t'i propozojë titullarit të organit për ta rishikuar masën e dhënë dhe se vendimi i titullarit është i formës së prerë. Në pikën 5 të nenit 32 parashikohet e drejta e ankimit kundër vendimit të formës së prerë në gjykatë dhe se "për rastet e pikës "e" të nenit 29, ankimi mund të bëhet edhe drejtpërdrejt në gjykatë" (kjo ka të bëjë me përjashtimin nga policia).

Duke pasur parasysh sa u përmend, del qartë se punonjësi i policisë, për të cilin është marrë masë disiplinore përjashtimi nga policia, ka të drejtë që ankimin ta bëjë në gjykatë për të kundërshtuar vendimin e marrë nga titullari i organit.

Është e qartë se në rastin e marrjes së masës disiplinore "përjashtim nga policia", kemi të bëjmë me zgjidhjen e kontratës së punësimit në mënyrë të njëanshme, por pakica ka mendimin se është i padrejtë arsyetimi i shumicës se rikthimi në punë nuk i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor, pasi ai është në diskrecionin e administratës së policisë dhe se rikthimi ose jo në punë i të larguarit apo të përjashtuarit nga policia është vetëm në të drejtën e saj.

Është e vërtetë se në nenin 32/5 të ligjit "Për Policinë e Shtetit", njihet e drejta që në rastet e përjashtimit nga policia, ankimi mund të bëhet drejtpërdrejt dhe nuk parashikohet se çfarë mund të vendosë gjykata dhe a mund të shprehet ajo për rikthim në detyrë. Mendojmë se, pavarësisht se nuk shprehet për rikthim në punë, nuk është i drejtë arsyetimi se gjykata nuk e ka një të drejtë të tillë dhe se në rastet e shqyrtimit të një ankimi për përjashtim nga detyra, ajo ka vetëm të drejtë të konstatojë ose të vërë në dukje shkeljen e ligjit.

E drejta e ankimit në gjykatë kundër vendimit (urdhrit) për përjashtimin nga policia, është e drejtë personale, por ashtu si në çdo rast tjetër të shqyrtimit gjyqësor, ushtrimi i kësaj të drejte, e vë detyrimisht gjykatën para problemit të zgjidhjes së çështjes që shqyrton. Nuk mund të kuptohet roli i gjykatës dhe roli vendimmarrës i saj, vetëm me konstatimin apo vënien në dukje të shkeljes pa i dhënë rrugëzgjidhje çështjes në shqyrtim, përderisa ka të drejtën e shqyrtimit. Ligji nuk kufizon mënyrën e zgjidhjes së çështjes nga gjykata e për pasojë, kur paditësi kërkon rikthimin në punën e mëparshme dhe gjykata e pranon të drejtë këtë zgjidhje, ajo ka të drejtë të vendosë për rikthimin në punë gjë që duhet pranuar si për gjithë rastet e tjera që ajo shqyrton çështjet që janë në kompetencë të saj. Kjo del edhe nga përmbajtja e nenit 112 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit "gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetimin se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë". Arsyetimi i bërë më sipër mund të gjejë mbështetje edhe në ligjin nr.8670, datë 26.10.2000 "Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë" në nenin 28 të të cilit parashikohet e drejta e ushtarakut që, kur mosmarrëveshjet nuk zgjidhen, të ankohet në gjykatë dhe se (pika 3) "Kur akti i shfuqizuar nga gjykata ka të bëjë me nxjerrjen në rezervë ose me lirimin e ushtarakut, ai ka të drejtë të rikthehet në detyrën e mëparshme ose një detyrë tjetër të njëjtë me atë të mëparshmen".

Duke pasur parasysh sa u përmend, pakica ka mendimin se vendimi i Gjykatës së Rrethit

Gjyqësor Shkodër është i drejtë e i bazuar në ligj, ndaj duhej vendosur prishja e vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër e lënia në fuqi e vendimit të gjykatës së rrethit.

Natasha Sheshi, Valentina Kondili, Kristaq Ngjela, Spiro Spiro, Vladimir Metani, Artan Hoxha

V E N D I M
Nr.15, datë 27.8.2003

PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR SHFRYTËZIM TË CENTRALEVE ELEKTRIKE DHE PRODHIM TË ENERGJISË ELEKTRIKE SHOQËRIVE "ESSEGEI-SMOKTHINA" SHPK "SAROLLARI" SHPK, "SARMIER" SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të Entit të Rregullimit të Sektorit të Energjisë Elektrike, mbasi shqyrtoi kërkesat e paraqitura nga shoqëritë "ESSEGEI-SMOKTHINA" sh.p.k. "Sarollari" sh.p.k. dhe "Sarmier" sh.p.k. për marrje licence për shfrytëzimin e centraleve elektrike, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga ana e tyre:

V E N D O S I:

1. Dhënien e licencave shoqërive "ESSEGEI-SMOKTHINA" sh.p.k. "SAROLLARI" sh.p.k. dhe "SARMIER" sh.p.k. për kryerjen e veprimtarisë së shfrytëzimit të centraleve elektrike dhe prodhimit të energjisë elektrike.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I ERE-S
Ing.Engjëll Çuçi

U R D H Ë R
Nr.17/3, datë 18.8.2003

PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË ORGANIZATËS SË MENAXHIMIT TË PESHKIMIT (OMP DURRËS)

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 dhe nenit 31/1 të ligjit nr.7908, datë 5.4.1995 "Për peshkim dhe akuakulturën",

V E N D O S A:

1. Miratimin e Statutit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP) Durrës, që i bashkëngjitet këtij urdhri.
2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
Agron Duka

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:



Doli nga shtypi më 5.9.2003

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë